

NJOFTIM
Nr. 6679, datë 5.12.2022

**PËR KANDIDIM PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË STATISTIKAVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikatat zyrtare”, dhe të pikës 2, të vendimit nr. 670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e për zgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, shpallim njoftimin për kandidim për anëtarë të Këshillit të Statistikave.

Konkurrimi është i hapur për përfaqësues që u përkasin **përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, botës akademike, shoqërisë civile dhe medias.**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të Këshillit të Statistikave, që propozohen nga Këshilli i Ministrave janë, si më poshtë vijon:

Kandidati për anëtar, përfaqësues i përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare:

- i. Të jetë nga radhët e nëpunësve civilë të Kryeministrit, të cilët merren, kryesisht, me hartimin e strategjive zhvillimore dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- ii. Të jetë nëpunës civil, të paktën i nivelit të mesëm drejtues;
- iii. Të ketë lidhje me përdorimin e të dhënave statistikore në natyrën e punës së tij;
- iv. Të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në përdorimin e statistikave.

Kandidati për anëtar, përfaqësues i botës akademike:

- i. Të jetë nga radhët e personelit akademik, i punësuar me kohë të plotë, në institucione të arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar e akredituar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
- ii. Të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e statistikave ose të ekonomisë apo të shkencave të natyrës;
- iii. Të zotërojnë tituj akademikë.

Kandidati për anëtar, përfaqësues i shoqërisë civile:

- i. Të jetë nga radhët e organizatave jofitimprurëse, që përdorin tregues statistikorë për kryerjen e veprimtarisë së tyre;
- ii. Të jetë i punësuar në organizatë për jo më pak se 3 (tre) vjet;
- iii. Të jetë i angazhuar në përdorimin e statistikave në fushat e ekonomisë, të shkencave të natyrës apo të shkencave sociale.

Kandidati për anëtar, përfaqësues i medias:

- i. Të jetë nga radhët e medias kombëtare;
- ii. Të jetë i punësuar me kohë të plotë;
- iii. Të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e gazetarisë ekonomike.

Kritere të përgjithshme:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të jetë person i padënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

Shënim. Kandidatët për anëtarë në Këshillin e Statistikave duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin, që provon plotësimin e kriterëve sipas kategorive përkatëse.

Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit, organizatat e shoqërisë civile duhet të paraqesin kandidatët përkatës, së bashku me dokumentet e nevojshme, përfshirë:

- kërkesën për aplikim;
- *Curriculum Vitae CV*;

- referencat dhe letrat mbështetëse nga 5 organizata jofitimprurëse;
- dokumente dhe deklarata të tjera provuese për vërtetimin e përmbushjes së kritereve të kandidimit, si më lart.

Afati i dorëzimit të aplikimit është deri më 22.12.2022 dhe të dorëzohet në adresën e Kryeministrit. Kandidatët e kualifikuar do të njoftohen nëpërmjet *e-mail*-it.

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1000

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Tel: 04 22 77 401